



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2022:183757

Datë: 17.12.2024

Numri i dokumentit: 06607945

C.nr.1287/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Mirvet Thaqi, duke vendosur në çështjen juridike-kontestimore të paditëseve D. M., nga fshati . . . , komuna Gjakovë dhe D. Gj., nga fshati . . . , komuna Gjakovë, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson Ilir Rogova, avokat me seli të zyrës në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike: kompensim i pagës shtesë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 17.12.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditëseve me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit që:
- Paditëses D. M., nga fsh. . . . , komuna Gjakovë, në emër të punës së kryer për 12 ditë të fundjavës, për gjithsej 60 orë pune, gjatë periudhës kohore 15.05.2021 – 26.02.2022, t’ia kompensoj pagën shtesë në shumën prej 191.80 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në emër të kontributeve për Trustin pensional shumën prej 11.28 euro dhe shumën prej 22.56 euro në emër të tatimit në burim, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.
  - Paditëses D. Gj., nga fsh. . . . , komuna Gjakovë, në emër të punës së kryer për 12 ditë të fundjavës, për gjithsej 96 orë pune, gjatë periudhës kohore 15.05.2021 – 26.02.2022, t’ia kompensoj pagën shtesë në shumën prej 176.08 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në emër të kontributeve për Trustin pensional shumën prej 10.36 euro dhe shumën prej 20.72 euro në emër të tatimit në burim, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditëset nëpërmjet të autorizuarit të tyre me datë 02.09.2022 pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i pagës shtesë nga marrëdhënia e punës.

*Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Përfaqësuesi i paditëseve përmes padisë, ashtu edhe gjatë deklarimeve në seancë përgatitore, përkatësisht atë të shqyrtimit kryesor, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e tyre në tërësi si e bazuar, e cila kërkesëpadi është ndryshuar përmes parashtrësës së dorëzuar në këtë gjykatë më 27.11.2024, pas nxjerrjes së ekspertizës financiare. Paditëset në kuptim të nenit 261 të LPK-së e kanë bërë tërheqjen e pjesërishme të padisë dhe atë për pjesën 03.09.2019 deri më 14.05.2021, ashtu që tani e tutje objekt i shqyrtimit në këtë çështje mbetet kompensimi për periudhën 15.05.2021 e deri më 26.02.2022, ku të njëjtat janë obliguar nga e paditura që të punojnë edhe punë shtesë gjatë 12 ditëve të shtune, ashtu që për këtë periudhë kohore paditësja D. M. ka qenë e pranishme në punë gjatë fundjavës për 60 orë, ndërsa paditësja D. Gj. për 96 orë. Ka theksuar se baza juridike e kësaj padie është kompensimi i pagës shtesë, dhe e njëjta mbështetet në dispozitën e nenit 56 paragrafi 2 të Ligjit të Punës, e kjo sipas tij në saje të punës shtesë të kryer nga paditëset gjatë ditëve të fundjavës. Ka theksuar se paditëset e kanë vërtetuar faktin se kanë punuar ditëve të fundjavës edhe para miratimit të akteve nënligjore nga MASHT-i për kompensimin e ditëve të humbura gjatë pandemisë si pasojë e COVID-19 dhe se akti nënligjor nuk mund t'i cenojë të drejtat e punëmarrësit që burojnë nga Ligji i Punës.

Ka shtuar se paditëset janë të njoftuara mbi praktikën e kësaj gjykate në raport me aprovimin e padive me objekt lëndor identik sikurse kjo çështje, dhe të njëjtat kanë pritje legjitime se kërkesëpadia do të aprovohet edhe në raport me to dhe këtë e mbështetin edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastet: KI.76/10, KI.08/10, e po ashtu të njëjtat nuk presin që faktet dhe çështja e tyre të trajtohet ndryshe dhe këtë e mbështetin edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet KI.04/12 dhe KI.89/13.

Me parashtrësën për precizim të kërkesëpadi në aspektin objektiv, i kanë propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditëseve në tërësi si e bazuar, duke e detyruar të paditurën që

paditëseve në emër të punës së kryer gjatë fundjavës tua kompensoj shumëat si në vijim: paditëses D. M. në emër të punës së kryer për 12 ditë të fundjavës gjatë periudhës kohore 15.05.2021 – 26.02.2022, për gjithsej 60 orë punë t'ia kompensoj pagën shtesë në lartësi prej 191.80 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në emër të kontributeve për Trustin Pensional të Kosovës shumë prej 11.28 euro si dhe në emër të tatimit në burim për ATK-në shumë prej 22.56 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm; dhe për paditësen D. Gj. në emër të punës së kryer për 12 ditë të fundjavës gjatë periudhës kohore 15.05.2021 – 26.02.2022, për gjithsej 96 orë pune, t'ia kompensoj pagën shtesë në lartësi 176.08 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në emër të kontributeve për Trustin Pensional të Kosovës shumë prej 10.36 euro si dhe në emër të tatimit në burim për ATK-në shumë prej 20.72 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për padi shumë prej 156.00 euro, për taksën gjyqësore për padi shumë prej 21.00 euro, për përpilimin e parashtrësës për precizim 156.00 euro, për ekspertizën financiare shumë prej 151.00 euro dhe për dy seanca gjyqësore shumë prej 404.40 euro (202.20 euro për seancë), në shumë e përgjithshme prej 888.40 euro.

E paditura përmes përgjigjes në padi ashtu edhe deklarimeve të parashtruara në seancën përgatitore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, përmes përfaqësueses së autorizuar, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si dhe precizimin e bërë, duke theksuar se kompensimet monetare të kërkuara nuk u takojnë paditëseve dhe kjo vërtetohet me vendimin e nxjerrë nga MASHT-i si dhe udhëzimin administrativ për kalendarin e vitit shkollor 2021-2022 si dhe Ligjin e Punës, ku është përcaktuar saktë se kur punëmarrësve u takojnë kompensimet për paga shtesë. Shton se paditëset edhe gjatë periudhës së pandemisë duke mos qenë fare prezent në punë janë paguar rregullisht. Ka theksuar se paditëset nuk janë detyruar të punojnë në ditët e fundjavës nga e paditura siç përcaktohet në padinë e paditëseve, por se DKA në Gjakovë ka pranuar vendimin Nr.01B/292, i cili ka hyrë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga ana e ministres dhe i cili u është përcjellë të gjitha drejtorive të arsimit në nivel lokal. Ka shtuar se dispozita ligjore nga neni 56 e Ligjit të Punës, ku referohen paditëset, nuk i referohet rasteve kur kemi të bëjmë me kompensimin e orëve të humbura në punë, por punës shtesë krahas punës obligative me orar të plotë të punëmarrësit. Tutje ka shtuar se në rast të

moszbatimit të Vendimit nr.01B/2021 për kompensimin e ditëve të humbura për shkak të gjendjes me pandeminë COVID-19, nuk do të arrihej respektimi i dispozitave të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2021 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2021-2022 të lëshuar nga MASHT-i, që kanë të bëjnë me Ditët dhe javët e obliguara të mësimit dhe të punës dhe kjo do të shkaktonte parregullsi në mësimdhënie apo humbje të orëve të mësimit dhe për të paditurën këto janë orë të humbura dhe jo zëvendësim. Ka shtuar se paditëset gjatë fundjavës kanë punuar me orar të shkurtuar prej 30 minutash e jo 40 minuta. Mbi bazën e këtyre pretendimeve i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëseve ta refuzoj si të pabazuar.

*Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe gjendja faktike e vërtetuar*

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 02.12.2024 ka administruar provat materiale si në vijim: Listat e pagave për vitet 2021 – 2022 për secilën paditëse veç e veç; Kontrata e punës e dt. 01.09.2021, me nr. të prot. 26/1; Kontrata e punës e dt. 15.10.2020, pa nr. të prot.; Kontrata e punës e dt. 01.12.2022, pa nr. të prot.; Vërtetimi me nr. të prot. 1872/24 i dt. 21.02.2024 të lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin . . ., komuna Gjakovë; Vërtetimi me nr. të prot. 1889/24 i dt. 21.02.2024 të lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin . . ., komuna Gjakovë dhe Ekspertiza financiare e dt. 18.11.2024.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, përgjigjes në padi si dhe provave të administruara, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, duke çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Në këtë çështje juridike kontestimore rezulton se në mes të palëve nuk ishte kontestuese se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht si mësimdhënëse dhe punëtore tekniko-shërbyese në SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin . . ., komuna Gjakovë, sipas Kontratave të punës si më lartë, të lëshuara nga Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura.

Fakt kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse ishte baza juridike e kërkesëpadisë, se a kanë bazë ligjore paditëset për të kërkuar kompensimin e pagës shtesë nga e paditura, për punën e kryer gjatë fundjavës.

Nga Vërtetimi me nr. prot. 1872/24 të dt. 21.02.2024 të lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin . . ., komuna Gjakovë vërtetohet se paditësja D. M. gjatë periudhës 15.05.2021 e deri më 26.02.2022 ka punuar gjithsej 12 ditë të shtune, me një total prej 60 orë pune.

Nga Vërtetimi me nr. prot. 1889/24 të dt. 21.02.2024 të lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin . . ., komuna Gjakovë vërtetohet se paditësja D. Gj. gjatë periudhës 15.05.2021 e deri më 26.02.2022 ka punuar gjithsej 12 ditë të shtune, me një total prej 96 orë pune.

Gjykata me leximin e listave të pagës të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për secilën paditëse veç e veç për vitet 2021-2022, ka vërtetuar faktin se paditëset kanë realizuar pagë mujore, për punën e kryer pranë të paditurës.

#### *Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës*

Nga përmbajtja e kontratës së paditëses D. M., përkatësisht nenit II të saj (Detyrat e punës së punëkryesit), thuhet se “*Punë kryesi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës*”. Ndërsa, nga përmbajtja e kontratës së paditëses D. M. rrjedh se kjo e fundit është e obliguar që ti përmbahet punëve dhe detyrave të punës që rrjedhin nga përshkrimi i punëve për këtë vend të punës.

Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës në nenin 3 të tij ka përcaktuar parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar, ku në par.1 të kësaj dispozite parashihet se: “*Asnjë personi nuk guxon t’i mohohet e drejta për arsimim*”, ndërsa në par.2 përcaktohet se: “*Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj*”.

Në nenin 5, par.1 nënpar. 1.1 të Ligjit për arsimin parauniversitar parashihet se: “*Ministria mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, si dhe ka detyrat e përgjithshme që: 1.1. të zhvillojë politika, hartojë dhe zbatojë legjislacionin për zhvillimin e arsimit dhe aftësimin parauniversitar; Tutje, me nënpar. 1.8 të dispozitës së lartcekur parashihet se: “të dizajnojë*

*dhe mbikëqyrë format efektive të administrimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore dhe aftësuese për t'u zbatuar nga komunat dhe përcaktojë kritere dhe procedura të monitorimit të punës së Këshillit Drejtues". Derisa me nenin 5 par. 2.1 të këtij ligji është përcaktuar se: Ministria duhet të nxjerrë akte nënligjore lidhur me: "kalendarin shkollor dhe periudhën kohore të vitit shkollor në kuadër të Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës".*

Në nenin 8 par. 6.3 të këtij ligji parashikohet që: "Në rast se vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulumit, Ministria mund të kërkojë zbatimin e mësimit shtesë ose alternativ".

MASHT-i, duke vepruar konform Ligjit për Arsimin Parauniversitar, ka nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar planprogramin mësimor, konkretisht me datë 16.09.2020 ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 85/2020 për kalendarin e vitit shkollor 2020/2021, derisa me 20.08.2021 ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2021, për Kalendarin e Vitit Shkollor 2021-2022.

Me nenin 1 të këtyre udhëzimeve përcaktohet se "Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të përcaktoj fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor, respektivisht të vitit mësimor, sipas niveleve, pushimin dimëror, pushimin pranveror, festat publike për nxënësit e shkollave fillore, klasave parafillore, shkollave të mesme të ulëta, shkollave mesme të larta, institucioneve parashkollore dhe qendrat burimore për mësim dhe këshillim".

Në nenin 9 të këtyre udhëzimeve përcaktohet se "Ditët dhe javët e obliguara të mësimit dhe të punës";

1. Për nxënësit e shkollës së mesme të lartë-maturantët, janë të obliguar 160 ditë mësimi, tridhjetedy (32) javë,
2. Për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11-të, janë të obliguara, 175 ditë mësimi, 35 javë.
3. Për nxënësit e klasave 1-8 dhe fëmijët parafillor, janë të obliguara 184 ditë mësimi, 37 javë.
4. Institucionet parashkollore, duhet të marrin për bazë festat zyrtare në pajtim me nenin 8 të këtij udhëzimi.
5. Duke u mbështetur në ligjin e punës, institucionet parashkollore pushimin veror e planifikojnë jo më shumë se dy javë brenda periudhës 1 korrik – 15 gusht.

*5.1. Pushimi i stafit rregullohet sipas ligjit të punës, ndërsa pushimi kolektiv brenda periudhës së përcaktuar në pikën 5 merret për arsye të dezinfektimit dhe pastrimit të institucionit parashkollor dhe përgatitjes për vitin vijues.*

*6. Në Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim me konvikt, në rast se festa është gjatë ditëve të punës, u lejohet të planifikojnë zëvendësimin e mësimit, pa humbur nga ditët dhe javët e obliguara për mësim.*

*7. Për çdo ndryshim të kalendarit shkollor, MASHTI merr vendim të veçantë”.*

Pra, nga përkufizimi i kësaj dispozite, del se MASHT-i me akte nënligjore përcakton ditët dhe javët e obliguara të mësimit dhe të punës dhe se ndryshimi i këtij Udhëzimi, sipas nenit 9 par. 7 të tij, bëhet me vendim.

Bazuar në dispozitat e mësipërme rezulton se MASHT-i, ka kompetenca sipas paragrafit 1 të nenit 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar për të mbajtur përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, përgjegjësi kjo e cila sigurohet duke zhvilluar politika dhe legjislacion dhe kriteret për licencim të mësimdhënësve. Ndërsa, me nenin 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar ky institucion ka kompetencën “që të kërkojë zbatimin e mësimit shtesë ose alternativ në rast se vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulumit”.

MASHT-i në shtator të vitit 2020 kishte nxjerrë Udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet dhe rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19, ku ndër qëllimet kryesore ishte edhe organizimi i mësimit sipas kushteve epidemiologjike në vend duke përfshirë edhe kushtet e rihapjes së institucioneve edukativo arsimore me masa të shtuara për shëndetin publik, si dhe realizimin e procesit edukativo arsimor sipas Kornizës së Kurrikulës të Kosovës (KKK), kurrikulave bërthamë për tre nivelet të arsimit parauniversitar, dhe plan-programeve mësimore/lëndore për secilën klasë në kushte të pandemisë COVID - 19 në Republikën e Kosovës.

Më pas, MASHT-i kishte nxjerrë Vendimin me nr.01B-101, të dt.11.09.2020 për fillimin e mësimit në vitin e ri shkollor 2020/2021 në kushte pandemie, ku përcaktohej që fillimi i vitit të ri shkollor 2020/21 në kushtet e pandemisë COVID-19 do të organizohej në dy faza, ashtu që faza e parë do të fillonte me 14 shtator 2020, me këtë datë do të fillonin mësimit të gjithë fëmijët e klasës parafillore dhe ata të klasave 1, 2, 3, 6 dhe 10, ndërsa klasat 4 dhe 5 do të

vijonin mësimin në shkollë (Sipas skenarit A) ose si mësim i kombinuar. Ndërkaq, faza e dytë parashihej të fillonte më 21 shtator 2020 dhe me këtë datë do të fillonin mësimin nxënësit e klasave 7, 8 dhe 9 të arsimit të mesëm të ulët dhe të klasave 11-12 të arsimit të mesëm të lartë.

Tutje, me datë 20.04.2021 MASHT-i kishte nxjerrë Vendimin me nr. 01B/22 për organizimin e mësimin plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e pandemisë COVID-19, duke përcaktuar që organizimi i mësimin plotësues do të implementohet në nivelin I, II dhe III të arsimit parauniversitar. Tutje, në këtë vendim parashihej që për nxënësit e nivelit të arsimit fillor (I-IV) mësimi plotësues do të organizohej në lëndët gjuhë amtare dhe matematikë, ndërsa për nxënësit e nivelit të mesëm të ulët (VI-IX) dhe të nivelit të arsimit të mesëm të lartë, mësimi plotësues do të organizohej në lëndët gjuhë amtare, matematikë dhe në shkencat natyrore. Organizimi dhe mbajtja e mësimin plotësues në institucionet arsimore parashihej të fillonte nga data 03 maj 2021 e të vazhdonte deri në përfundim të vitit mësimor 2020-2021, duke obliguar kështu DKA-të që të dorëzonin në Inspektoratin e arsimit (MASHTI) planifikimet e shkollave për organizimin dhe zhvillimin e mësimin plotësues. Në arsyetimin e këtij vendimi, theksohej se pandemia COVID-19 kishte ndikuar dhe rezultuar me humbjen e orëve mësimore në nivelin e arsimit parauniversitar në të gjithë vendin dhe kështu duke thelluar edhe më tej pabarazinë në mes të fëmijëve-nxënësëve. Tutje, në arsyetim të këtij vendimi konstatohej se *“mësimi plotësues është një prej mundësive që do të lehtësojë humbjen e mësimin, përshpejtimin e të nxënësve dhe përmirësimin e arritjeve të rezultateve të nxënësve”*.

Andaj, pas përfundimit të gjendjes pandemike, MASHT-i konform nenit 8 par. 7 të UA.nr.07/2021, ka nxjerr vendimin numër 01B/292 të datës 28.09.2021 për kompensimin e ditëve të mësimin të humbura për shkak të gjendjes me Pandeminë COVID-19, të Vitit Shkollor 2021-2022, me të cilin vendim ishte përcaktuar që të zëvendësohen 18 ditët e mësimin të humbura, për vitin shkollor 2021-2022, ashtu që 10 ditët të mësimin të zëvendësohen – mbahen të shtunave, duke përcaktuar edhe datat që nga muaji tetor 2021 e deri muajin shkurt të vitit 2022.

Nga të lartcekurat, gjykata vërteton se pretendimi i paditëseve për kompensimin e pagës shtesë për shkak të punës më të gjatë se sa orari i plotë i punës, është në tërësi i pabazuar, për arsye se orët e punës për paditëset si në kontratat e tyre të punës, janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 85/2020 për kalendarin e vitit shkollor 2020/2021, Udhëzimin Administrativ nr. 07/2021 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2021-2022, Vendimin me nr. 01B/22 për organizimin e mësimin plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë



e pandemisë COVID-19 si dhe në vendimin me numër 01B/292 të datës 28.09.2021 për kompensimin e ditëve të mësimit të humbura për shkak të gjendjes me Pandeminë COVID-19. Në këtë rast, për paditësen D. M. si mësimdhënëse lëndore kanë qenë të përcaktuara 184 ditë mësimi, (37) javë për nxënësit e klasave 1-8 dhe fëmijët parafillor, përkatësisht 175 ditë mësimi, (35) javë për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11-të, ndërsa në kontratën e saj të punës janë përcaktuar 20 orë mësimi në javë, përkatësisht 40 orë pune në javë, andaj paditësja me asnjë provë nuk e ka argumentuar faktin se e njëjta ka punuar më gjatë se sa orari i punës së përcaktuar në UA.nr.85/2020, UA.nr.07/2021 dhe në kontratën e saj të punës, e si rrjedhojë nuk mund të zbatohet neni 56 i Ligjit të Punës për kompensimin e punës jashtë orarit. Ndërsa, sa i përket paditëses D. Gj., me kontratat e punës të elaboruara si më lartë, janë përcaktuar orët e punës brenda një jave, përkatësisht 40 orë pune në javë. Andaj, rrjedh se paditëset me punën e realizuar gjatë të shtunave të periudhës maj 2021 dhe shkurt 2022, nuk kanë punuar orë shtesë, por të njëjtat kanë zbatuar vetëm detyrimin e tyre për të përmbushur orët e tyre mësimore, përkatësisht detyrat e punës të përcaktuara nga kontratat e punës, e në të cilën kontratë nuk janë të përcaktuara ditët e javës brenda të cilave duhet të përmbushën orët mësimore, respektivisht detyrat e punës, por vetëm fondi i orëve mësimore-orëve të punës, andaj me Vendimin me nr. 01B/22 për organizimin e mësimit plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe Vendimin për kompensimin e ditëve të mësimit të humbura për shkak të gjendjes me Pandeminë COVID-19, kjo nuk nënkupton faktin se paditëset në mënyrë burimore kanë punuar orë më tepër se sa ato të përcaktuar në UA.nr.85/2020 dhe UA.nr.07/2021 dhe kontratat e tyre të punës, si dhe fakti se ato kanë punuar ditëve të shtune, në asnjë formë nuk ka cenuar të drejtat e tyre që rrjedhin nga Ligji i Punës, pasi që është fakt i njohur botërisht që të gjithë mësimdhënësit dhe stafi teknik, duke përfshirë edhe paditëset, gjatë periudhës së pandemisë, kanë realizuar pagën e rregullt mujore sikurse të kishin punuar. Andaj, gjykata ka vlerësuar se këto dispozita të këtyre akteve normative vlejné edhe për punën në kohën e pushimit pranveror, veror dhe dimëror.

Në raport me ekspertizën nga lëmia financiare, Gjykata trajtoi me vëmendje përmbajtjen dhe të gjeturat e kësaj ekspertize, me ç'rast erdhi në përfundim se e njëjta është përpiluar në kuadër të standardeve dhe parametrave të kërkuara profesionale. Megjithatë, bazuar në faktin se vlerësimi përfundimtar i Gjykatës konsiston në qëndrimin që paditëseve u mungon baza ligjore e mbështetjes së kërkesëpadisë, të gjitha provat e administruara në këtë procedurë, e me të cilat determinohet çështja e lartësisë së kërkesëpadisë, nuk janë relevante dhe me peshë të veçantë në drejtim të krijimit të bindjes për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, po ashtu, edhe provat e tjera, të cilat janë administruar në shqyrtim kryesor, mirëpo, të njëjtat nuk ishin relevante dhe nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestuese.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 “*Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta*”, e lidhur me nenin 463.1 të LPK-së “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën*”, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin 143 të LPK-së.

#### GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm,  
C.nr.1287/22, datë 17.12.2024

Gjyqtari  
Mirvet Thaqi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.